



FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS

BADMINTON SAVEZ KOSOVO

BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO

Tel&Fax+ 383 132 917 +383-44-211-434; Rr.“Agim Ramadani” 10, 10000 Prishtinë

www.badminton-rks.org, email: b.f.kosovo@gmail.com

RAPORTI I PUNËS 01.01.2024 -31. 12.2024

Përmbajtja:

1.	NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT NË MES MKRS DHE BFK-së	4
2.	KUVENDI I VI I PUNËS SË FEDERATËS SË BADMINTONIT TË KOSOVËS 24.03. 2024	5
3.	Promovimi i badmintonit në SHFMU “LIRIA” – Pogradë – Gjiat	6
4.	Promovimi i badmintonit në SHFMU “Kongresi i Manastirit” – Gllamnik- Podujevë.....	8
5.	KAMPIONATI INDIVIDUAL I KOSOVËS NË BADMINTON	9
6.	KAMPIONATI INDIVIDUAL I KOSOVËS NË BADMINTON	12
7.	Promovimi i badmintonit në SHFMU “Emin Duraku” – Kaçanik	15
8.	KAMPIONATI NË QIFTE (DOUBLE) I KOSOVËS NË BADMINTON	16
9.	Raporti i Garës Internacional Open U13, U15, U-17 Svilengrad -Bullgari	20
10.	Raporti i Garës Internacional OpenU-19 Svilengrad -Bullgari	23
11.	Seminari për Administrator të Sportit e organizuar nga KOK	25
12.	KONGRESI VJETOR I FEDERATËS EVROPIANE TË BADMINTONIT (BEC) NË BUDAPEST-HUNGARI 22-26/05/2024	26
13.	KAMPIONATI MIKS I KOSOVËS NË BADMINTON	27
14.	KAMPIONATI TOP 5 MË TË MIRËT E KOSOVËS NË BADMINTON.....	31
15.	Raport i turneut Ballkanik ne Korçë“ Idas Frinds”	33
16.	KAMPI PËRGADITOR I KOMBETARES U-17,U-19, 04-08.04.2024	35
17.	RAPORTI I GARAVE CROATIA VALAMAR JUNIOR OPEN 2024	37
18.	Kursi bazik në Badminton në projektin “Shuttle Time” për mësimdhënës i mbajtur me	40
19.	Java Evropiane e Sportit BEAKTIV 27/09/2024.....	42
20.	Kampionati individual AIR badminton për Veteran të mbajtur në Durrës me 26 dhe 27 Shtator 2024.	43
21.	Kampionati individual në Badminton sezoni vjeshtor 19.10.2024.....	44
22.	TURNIRI MEMORIAL TRADICIONAL PROF. “JETON NEBIU” 24.10.2024.....	47
23.	Projekti Rajonal për vullnetarizëm Sofia 04-06 Tetor -2024	49
24.	KAMPIONATI DOUBLE I KOSOVËS VJESHTOR NË BADMINTON 10.11.2024	50
25.	KAMPIONATI MIKS I KOSOVËS VJESHTOR NË BADMINTON 17.11.2024.....	54
26.	AUSTRIAN U17 INTERNATIONAL 2024 “ Mödling, Vienna-Austria (04-06 Tetor, 2024.....	56
27.	GARAT NDERKOMBETARE TE MBAJTURA NE MULHEIM DER RUHR-GJERMANI	58
28.	„IV U17 PORTUGAL OPEN 2024 “ Caldas da Rainha-Portugal (22-24 Nentor, 2024)	60
29.	Kuvendi Zgjedhor i Federatës së Badmintonit të Kosovës	62
31.	KAMPIONATI INDIVIDUAL NË BADMINTON SEZONI VJESHTOR 19.10.2024.....	69
33.	VIZITA ZYRTARE NË „VICTOR EUROPE“	79
	Hörst, Hamburg, Gjermani (05-07 Janar, 2025)	79
34.	FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS (BFK)	80
	Pasqyra e Pozicionit Financiar	80
	Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	81

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	82
35. RAPORTI I KËSHILLIT MBIKQYRËS	83
36. Raporti i Auditorit 1.01.2024-31.12.2024:	2

1. NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT NË MES MKRS DHE BFK-së

Nënshkrimi i memorandumit në mes MKRS-së të përfaqësuar nga Zv.Ministri, Daulina Osmani dhe kryetari i Federatës së Badmintonit, Lulzim Haziri më datën 08.02.2024, nënshkruan memorandum bashkëpunimi me qëllim të mbështetjes financiare drejt realizimit të planit të veprimit dhe objektivave të BFK- së, për vitin 2024



2. KUVENDI I VI I PUNËS SË FEDERATËS SË BADMINTONIT TË KOSOVËS 24.03. 2024

Federata e Badmintonit e Kosoves sot mbajti Kuvendin e 6 te Punes te vitit 2023 në premisat e Komitetit Olimpik te Kosoves në prani të 17 delegatëve nga 21 sa ishin të ftuar.

Mbledhjen e hapi kryetari i Federatës së Badmintonit të Kosovës i cili i përshëndeti të pranishmit dhe njoftoi për rendin e ditës të cilin e miratuan të pranishmit. Prezent në mbledhje ishte edhe nënkryetari i KOK-ut, Gazmend Maxhuni.



3. Promovimi i badmintonit në SHFMU “LIRIA” – Pogradjë – Gjilan

Më 28.03.2024 në fshatin Pogradjë u promovua sporti i badmintonit në SHFMU "Liria" në Pogradjë, fushën sportive për të gjithë.

Sekretari i federatës së badmintonit të Kosovës dhe prof. Besnik Kastrati promovuan sportin e badmintonit duke i shpjeguar për elementet bazike në këtë sport. Drejtori i shkollës, Avdil Islami dhe prof. Florim Ferizi prof i Ed. Fizike na mirëpritën dhe u zotuan se do të themelojnë klubin e ri e që do ta pagëzojnë me emrin Liria.

Në emër të federatës së badmintonit të Kosovës e falënderojmë nikoqirin për mikëpritje të cilët njëherit u mbështetën me rekuizita sportive.





4. Promovimi i badmintonit në SHFMU “Kongresi i Manastirit” – Gllamnik- Podujevë

Më 29.03.2024 në fshatin Gllamnik u promovua sporti i badmintonit në SHFMU "Kongresi i Manastirit" në Gllamnik komuna e Podujevës.

Sekretari i federatës së badmintonit të Kosovës dhe prof. Besnik Kastrati promovuan sportin e badmintonit duke i shpjeguar për elementet bazike në këtë sport. Drejtori i shkollës, Sedat Abdullahu dhe prof. Ardijan Hamiti prof i Ed. Fizike na mirëpritën dhe u zotuan se do të themelojnë klubin e ri e që do ta pagëzojnë me emrin Llapi.

Në emër të federatës së badmintonit të Kosovës e falënderuam nikoqirin për mikëpritje të cilët njëherit e mbështetëm me rekuizita sportive dhe i urojmë suksese drejt realizimit të objektivave të përbashkëta.



5. KAMPIONATI INDIVIDUAL I KOSOVËS NË BADMINTON

30 dhe 31.03.2024 Bardhosh

Në ambientet e palestrës së Sporteve Imperium në Bardhosh – Prishtinë me një fjalë rasti i përshëndeti kryetari Lulzim Haziri i cili bëri hapjen e garave pas ri-licencimit të Federatës së Badmintonit duke i inkurajuar që sportistët të tregojnë lojë cilësore me moton që ta respektojmë njëri tjetrin duke fituar më i miri. U zhvilluan garat në të gjitha kategoritë individuale duke filluar nga grupmoshat U-11, U-13. U-15 dhe Senior për dy ditë rreshtë . Rezultatet: Pjesëmarrës në këtë eveniment ishin mbi 120 garues duke u inkorporuar 8 klube nga e gjithë Kosova. Madhështinë e këtij eventi i dhanë padyshim lojtarët e këtyre klubeve: K. B. Ulpiana, Dardania, Gjilani, Don Bosko, Vllaznimi, Arbëria, Rogana dhe AS Prishtina, ku u arritën këto rezultate:

U-11 Vajza	U-11 Djemtë
1. Atila Hoxha – “Vllaznimi” 2. Mara Hyseni – “Don Bosko” 3. Lea Delia – “Vllaznimi”	1. Lorent Muji – “Don Bosko” 2. Endrit Avdyli – “Dardania” 3. Malsim Latifi – “Don Bosko”

U- 13 Vajzat	U-13 Djemtë
1. Amra Lleshi – “Vllaznimi” 2. Riga Latifi – “Don Bosko” 3. Leona Bakalli – “Vllaznimi”	1. Orges Morina – “Arbëria” 2. Eset Kryeziu – “ Rogana” 3. Dion Dibrani – “Dardania”

U- 15 Vajzat	U-15 Djemtë
1. Tringa Ibraj – “Vllaznimi” 2. Leandra Thaqi – “Vllaznimi” 3. Dhurata Morina – “Arbëria”	1. Adriatik Avdyli – “Dardania” 2. Ajan Kryeziu – “ Rogana” 3. Edrin Aliu – “Gjilani”





6. KAMPIONATI INDIVIDUAL I KOSOVËS NË BADMINTON

30 dhe 31.04.2024 Bardhosh

Në ambientet e palestrës së Sporteve Imperium në Bardhosh – Prishtinë me një fjalë rasti i përshëndeti kryetari Lulzim Haziri i cili bëri hapjen e garave pas ri-licencimit të Federatës së Badmintonit duke i inkurajuar që sportistët të tregojnë lojë cilësore me moton që ta respektojmë njëri tjetrin duke fituar më i miri. U zhvilluan garat në të gjitha kategoritë individuale duke filluar nga grupmoshat U-17., dhe Senior për dy ditë rreshtë . Rezultatet: Pjesëmarrës në këtë eveniment ishin mbi 120 garues pjesëmarrës duke u inkorporuar 8 klube nga e gjithë Kosova. Madhështinë e këtij event i dhanë padyshim lojtarët e këtyre klubeve: K. B. Ulpiana, Dardania, Gjilani, Don Bosko, Vllaznimi, Arbëria, Rogana dhe AS Prishtina, ku u arritën këto rezultate:

U- 17 Vajzat	U-17 Djemtë
1. Melisa Cermjani – “Vllaznimi” 2. Erisa Beqiraj – “Dardania” 3. Gentrina Cermjani – “Vllaznimi”	1. Bardh Guda “ Rogana” 2. Dionis Morina – “Arbëria” 3. Andijon Aliu– “Gjilani”
U-19dhe Senioret Vajzat	U-19 dhe Senioret – Djemtë
1. Suela Keka “ Rogana” 2. Fiona Mustafa– “Don Bosko” 3. Alesia Kastrati “ Rogana”	1. Baton Haxhiu – “Vllaznimi” 2. Dior Thaqi – “Vllaznimi” 3. Julian Komani – “Vllaznimi”









7. Promovimi i badmintonit në SHFMU “Emin Duraku” – Kaçanik

02.04.2024

Ne sot para nje grupi te femijëve të kësaj shkolle promovuam lojën e Badmintonit me elementet e lojës së Badmintonit.

Interesimi i nxënësve ishte i mirë për të mësuar lojën e badmintonit të cilët e mirëpritën dhe ishte shumë atraktive për nxënësit e kësaj shkolle.

Ne këtë promovim pjesëmarrës në cilësinë e edukatorëve (trajnerëve) ishin, prof. Afrim Morina dhe Besnik Kastrati poashtu këtë promovim na e mundësoi kolegu ynë njëherit profesori i kësaj shkolle, Lulzim Krasniqi



8. KAMPIONATI NË CIFTE (DOUBLE) I KOSOVËS NË BADMINTON

27.04.2024 Bardhosh - Prishtinë

Në ambientet e palestrës së Sporteve Imperium në Bardhosh – Prishtinë me një fjalë rasti i përshëndeti kryetari, Lulzim Haziri i cili bëri hapjen e garave duke i inkurajuar që sportistët të tregojnë lojë cilësore dhe fer. U zhvilluan garat në të gjitha kategoritë në qifte duke filluar nga grupmoshat U-11, U-13, U-15, U-17, U-19, dhe Senior. Rezultatet: Pjesëmarrës në këtë eveniment ishin mbi 120 garues pjesëmarrës duke u inkorporuar 8 klube nga e gjithë Kosova.

Madhështinë e këtij eventi i dhanë padyshim lojtarët e këtyre klubeve: K. B. Ulpiana, Dardania, Gjilani, Don Bosko, Vllaznimi, Arbëria, Rogana dhe AS Prishtina, ku triumfuan këta lojtarë:

U-11 Vajzat	U-11 Djemt
1. Atila Hoxha- Lea Delia “Vllaznimi” 2. Leona Bakalli- Mjellma Mehmeti“Vllaznimi” 3. Jara Ramadani- Tringa Kulla “Don Bosko”	1. Lorent Muji- Albin Esati “Don Bosko” 2. Malsim Latifi- Jan Shabani “Don Bosko”

U- 13 Vajzat	U-13 Djemtë
1. Amra Lleshi- Ema Delia “Vllaznimi” 2. Mara Hyseni -Riga Latifi “Don Bosko”	1. Orges Morina- Eset Kryeziu “Arbëria” 2. Lorent Muji-Drilon Ukshini “Don Bosko”

U- 15 Vajzat	U-15 Djemtë
1. Tringa Ibraj-Leandra Thaqi “Vllaznimi” 2. Dhurata Morina- Erona Morina “Arbëria”	1. Erdi Grapci -Enes Bashiq “Dardania” 2. Ajan Kryeziu- Malsor Sejdiu “Rogana” 3. Edrin Aliu- Reart Hasani “Gjilani”

U- 17 Vajzat	U-17 Djemtë
1. Melisa Cermjani- Gentrina Cermjani 2. Rita Guda- Venesa Fera 3. Anesa Krasniqi- Agnesa Krasniqi	1. Bardh Guda- Aid Kastrati “Rogana” 2. Dionis Morina- Bulent Mustafa “Arbëria” 3. Fjoral Kallaba- Erdi Kryeziu “Rogana”
U- 19 Seniore Vajzat	U-19 Senior Djemtë
1. Suela Keka- Alesia Kastrati “Rogana” 2. Fjona Mustafa- Olsa Zymberi “Don Bosko” 3. Andrra Bala- Mrekullina Thaqi “Vllaznimi”	1. Baton Haxhiu- Dior Thaqi “Vllaznimi” 2. Ertol Lenjani- Ilmi Spahiu“Rogana” 3. Enis Selishta- Leonit Hashani “Rogana”





9. Raporti i Garës Internacional Open U13, U15, U-17 Svilengrad -Bullgari

Udhëtimi u bë me datën 08.05.2024 me minibus (Victoria Tours)

Në këtë ekspeditë ishin 11 lojtarë 3 trajnerë (Afrim Morina, Vilson Hajdari, Shpresa Berisha) dhe Menagjeri (Agron Sheremeti)

Qëndruam në hotelin “ Parish “

Në këtë garë morën pjesë 9 shtete (por ka pas numër herë më të madh e herë më të vogël të shteteve pjesëmarrëse, varësisht nga kategoritë e lojtarëve).

Në këtë garë vlen të theksohet fitorja e parë e Kosovës në një kompeticion të tillë të garave dhe ajo ishte në kategorinë U-13 djemtë, Eset Kryeziu nga Klubi “ Rogana Badminton” me rezultat 2:0 ndaj lojtarit nga Bullgaria, Kristian Dimitrov 21:12 dhe 21:12 poashtu edhe tek vajzat, Amra Lleshi (Vllaznimi) - Zacaro Papurousopollau (Greqi) 21-16 dhe 21-17

Këta dy lojtarë bëjnë historinë për Kombëtarën e Kosovës në garat ndërkombëtare.

Kthimi për Kosovë do të bëhet me datën 11.05.2024

Gara U-13,U-15

Svilengrad

08.05.2024

Rezultatet

Ora 12:00. Adriatik Abdyli - Georgi Rupstov . (01-21; 0-21)

Ora 12:30. Ajan Kryeziu-George Iliev (07-21; 09-21)

Ora 01:00. Leandra Thaqi - Teodora Pavlova (04-21; 02-21)

15:30. Tringa Ibraj-Ceylimaz Muncu (13-21; 04-21)

Ora 10:00. Adriatik Abdyli -Mehmet Kamqakan (08-21; 07-21)

Ora 10:30. Leandra Thaqi -Zehra Kabadash (14-21; 09-21)

Ora 11:00. Tringa Ibraj-Gergana Hristozova (19-21; 21-19; 21-23)

Ora 11:30. Ajan Kryeziu-Filip Iska (03-21; 02-21)

Qiftet

16:30. Leandra Thaqi-Tringa Ibraj - Eva Tvabonjam-Ivet Edveva (12-21; 9-21)

Ora 15:30. Adriatik Abdyli-Ajan Kryeziu - Ajaz Kilic-Envar Zahid (02-21; 05-21)

09.05.2024

Svilengrad

U-13 Individuale dhe Qifte

U-17 Individuale

Eset Kryeziu-Kristian Dimitrov (21-12; 21-12)

Orges Morina-Dimiter Dimitrov (09-21; 14-21)

Amra Lleshi-Slavena Stameva (06-21; 06-21)

Eset Kryeziu-Cam Emuria (08-21; 09-21)

Orges Morina-Krum Bakallov (07-21; 09-21)

Amra Lleshi-Zakavo Papurusapullus (17-21; 22-24)

Eset Kryeziu-Tomboguet (10-21; 12-21)

Orges Morina-Lorim Perfito (05-21; 07-21)

Qifte

Orges-Morina-Eset Kryeziu - Diamantis Kaligas-Krum Bakallov (14-21; 08-21)

Amra Lleshi-Borisa Andrevna-Marina Petkova 0:2 me sete

Dionis Morina-Georgi Vasilev (10-21; 08-21)

10.05.2024

U-17 djem, vajza, individual, mix,qift

Dionis Morina-Melisa Cermjani - Yazici Cengizhan-Gyzel Meyrem (03-21;04-21)

Bardh Guda-Erisa Beqiraj - Meizzo Davide-Dognottimarghe (04-21; 04-21)

Solo

Melisa Cermjani - Bojanova Bozhidara (05-21; 01-21)

Bardh Guda - Pol Foltes (11-21; 03-21)

Erisa Beqiraj - Jemisen Yargmur (03-21; 05-21)

Qifte

Dionis Morina-Bardh Guda - Muhamet Eren Bilgen-Cengizhanya Zici (07-21;08-21)

Erisa Beqiraj-Melisa Cermjani - Zisan Yaren Ceilan-Seibuket Koc (10-21;08-21)

Raportin e përgatiti

Afrim Morina





10. Raporti i Garës International Open U-19 Svilengrad -Bullgari

Udhëtimi filloi me 11,05-15-05/2024

Lojtarët dhe stafi udhëheqës u takuan në Prishtinë,ku pjesëmarrës ishin 4 lojtarë dhe dy udhëheqës.Lojtarët ishin Fiona Mustafa,Suela Keka,Baton Haxhiu dhe Dior Thaqi, udhëheqës të ekipit ishin trajneri Besnik Kastrati dhe Menaxher Tefik Fazliu.

Udhëtimi deri në Svilengrad shkoi mirë dhe vendosja në hotel gjithashtu ishte e mirë.

Garat filluan të hënën me 03.05,2024 ,koha e rezervuar për lojtarët tanë ishte të hënën dhe të martën dhe lojtarët tanë u paraqitën në palestër me kohë mirëpo nuk patën ndonjë rezultat pozitiv,megjithatë patën një paraqitje solide dhe rezultatet janë këto:

Fiona Mustafa 5 3
Sofia Galimberti 21 21

Baton Haxhiu 8 9
Fatih Erdogan 21 21

Suela Keka 7 9
Ayndi 21 21

Dior Thaqi 8 8
Ben chater 21 21


Suela Keka -Fiona Mustafa 6 8
Ekipi nga Turqia 21 21

Baton Haxhiu-Suela Keka 4 5
Ekipa nga Sllovakia 21 21

Baton Haxhiu-Dior Thaqi 5 6
Ekipa nga Turqia 21 21

Dior Thaqi-Fiona Mustafa 2 2
Ekipa nga Turqia 21 21





11. Seminari për Administrator të Sportit e organizuar nga KOK

Në Ambientet e Komitetit Olimpik të Kosovës përmes Akademisë Olimpike, ka organizuar kursin e radhës për administratorë të sportit, ku pjesëmarrës këtë herë ishin administratorë nga Federata e Badmintonit e Kosovës dhe Ciklizmit të Kosovës. Për dy ditë, kursin e vijuan 23 zyrtarë të federatave dhe klubeve përkatëse, të cilët në fund morën edhe certifikata të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Ligjërues ishin drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, Ibër Alaj (MEMOS XIX), koordinatori për edukim në Akademinë Olimpikë, Fitim Arifi dhe ish sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Stavri Bello, njëherit anëtarë i Bordit Ekzekutiv të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare.

Vijuesit e kursit mësuan për hartimin e planit strategjik të organizatave sportive.

Të certifikuar për Administratorë të Sportit nga Federata e Badmintonit janë:

Olsa Zymberi dhe Selami Haziri K.B. Don Bosko

Hazir Aziri K.B. Gjilani

Andi Haxhiu dhe Jetar Thaqi K.B. Vllaznimi

Ylli Morina K.B. Arbëria

Ali Kastrati K.B Rogana



12.KONGRESI VJETOR I FEDERATËS EVROPIANE TË BADMINTONIT (BEC) NË BUDAPEST-HUNGARI 22-26/05/2024

Nga data 22 Maj, 2024 deri më datën 26 Maj,2024 u mbajtë Kongresi i Federatës Evropiane të Badmintonit (BADMINTON EUROPE CONFEDERATION) në Budapest, Hungari. Delegacioni i Kosovës u prezantua me dy delegatët, **Lulzim Haziri dhe Blerim Sylejmani**. Për Kosovën ky ishte Kongresi i dytë që mer pjesë në këtë kongres.

Delegacioni i Kosoves e kishte fluturimin nga Aeroporti i Shkupit me 22 Maj në ora 17:30. Në Budapest arritëm rreth ores 18:45, dhe u vendosëm në hotelin **PARK INN RADISSON**. Me 23 Maj 2024, nga ora 20:00-22:00 kishte takim nga delegacionet e tërë Evropës për mirëseardhje apo Welcome drinks. Pasi ishte edhe Kongresi që kishte edhe zgjedhje pasi se do zgjidheshin 2 Anëtarë të Bordit të BEC-it dhe 1 nënkryetar i BEC-it, kandidatët mundoheshin të takonin çdo federatë për vota.

Me 24 Maj, 2024 filloi Forumi. Fjalën hyrëse e mori Presidenti i BEC-it, Sven Sere, dhe u diskutua për Planin Strategjik, pastaj për Lojërat Olimpike në Paris, pastaj kandidatët kishin në dispozicion nga 5 minuta për kandidimin e tyre. Organizatori organizoi një darkë në qytetin e bukur të Budapestit.

Kongresi filloi me 25 Maj, 2024 nga ora 10:00 me fjalën hyrëse të Presidentit të BEC-it , Sven Sere, ku u miratuan të gjitha raportet për vitin 2023, dhe se u miratua buxheti prej 3,5 milion eurove dhe u vendos që kotizimi i Federatave të mbetet në fuqi sikurse në vitin 2023, në shumën prej 210 eurove.

Në mbrëmje u organizua një GALA MBRËMJE ku u ndanë cmimet për Lojtarin më të mirë të Evropës, lojtari më i ri i Evropës, doubles më të mirë të Evropës dhe Trajneri më i mirë i Evropës.Pastaj u dekoruan edhe ish lojtarët dhe ish presidenti i BEC-it, Peter Tarcala, për kontribut jetësor.

Delegacioni i Kosovës e lëshoi hotelin në ora 05:45 minuta të datës 26 Maj, 2024 dhe fluturimi nga aeroporti i Budapestit ishte në ora 08:20 ku në Shkup ateruam në ora 09:40.

Kongresi i BEC-it për vitin 2025 do të mbahet në: **BEOGRAD, SERBI**.





13. KAMPIONATI MIKS I KOSOVËS NË BADMINTON

19.05.2024 Bardhosh Palestra Imperium Medical

Në ambientet e palestrës së Sporteve Imperium Medical në Bardhosh – Prishtinë me një fjalë rasti i përshëndeti kryetari, Lulzim Haziri i cili bëri hapjen e garave Miks të Federatës së Badmintonit

duke i inkurajuar që sportistët të tregojnë lojë cilësore me moton që ta respektojmë njëri tjetrin duke fituar më i miri. U zhvilluan garat në të gjitha kategoritë Miks (Vajzë – djalë) duke filluar nga grupmoshat U-11, U-13, U-15, U17 dhe U19 dhe Senior. Rezultatet: Pjesëmarrës në këtë eveniment ishin mbi 120 garues pjesëmarrës duke u inkorporuar 8 klube nga e gjithë Kosova. Madhështinë e këtij eventi i dhanë padyshim lojtarët e këtyre klubeve: K. B. Ulpiana, Dardania, Gjilani, Don Bosko, Vllaznimi, Arbëria, Rogana dhe AS Prishtina, ku u arritën këto rezultate:

U-11 Vajza	U-13 Djemtë
1. Malsim Latifi- Mara Hyseni 2. Lorent Muji- Jara Ramadani 3.	1. Eset Kryeziu-Amra Lleshi 2. Lorent Muji- Riga Latifi 3. Dion Dibrani- Suela Gashi

U- 15 Vajzat	U-17 Djemtë
1. Rita Guda- Ajan Kryeziu 2. Arila Morina- Orges Morina 3. Adriatik Avdyli- Ema Gacaferi	1. Alisa Kastrati- Bardh Guda 2. Dhurata Morina- Dionis Morina 3. Erona Morina-Bulent Mustafa

U-19

Në kategorinë U-19 në gjysëm finale klubi “Vllaznimi” i tërhoqi lojtarët nga fusha e lojës për arsye se dëshironte të bëj ndryshimin e sistemit të garave dhe komisioni vendosi që garat të vazhdojnë sipas orarit të planifikuar ashtu siq ishin shortet.







14. KAMPIONATI TOP 5 MË TË MIRËT E KOSOVËS NË BADMINTON

08-09/06.2024 Bardhosh Palestra Imperium Medical

Në ambientet e palestrës së Sporteve Imperium Medical në Bardhosh – Prishtinë me një fjalë rasti i përshëndeti, kryetari Lulzim Haziri i cili bëri hapjen e garave Top 5 më të mirët në Kosovë që dy më të mirët do të përfaqësojnë Kosovën në Gara regjionale dhe ndërkombëtare duke i inkurajuar që sportistët të tregojnë lojë cilësore me moton që ta respektojmë njëri tjetrin duke fituar më i miri. U zhvilluan garat në të gjitha kategoritë – grupmoshat U-11, U-13, U-15, U-17 dhe U-19 dhe Senior. Rezultatet: Pjesëmarrës në këtë eveniment ishin mbi 70 garues pjesëmarrës duke u inkorporuar 8 klube nga e gjithë Kosova. Madhështinë e këtij eventi i dhanë padyshim lojtarët e këtyre klubeve: K. B. Ulpiana, Dardania, Gjilani, Don Bosko, Vllaznimi, Arbëria, Rogana dhe AS Prishtina, ku u arritën këto rezultate:

U-11 Vajza	U-11 Djemtë
1. Atila Hoxha 2. Lea Delia 3. Mjellma Mehmeti	1. Lorent Muji 2. Endrit Avdyli 3. Malsim Latifi

U- 13 Vajzat	U-13 Djemtë
1. Ema Delia 2. Amra Lleshi 3. Riga Latifi	1. Orges Morina 2. Eset Kryeziu 3. Dion Dibrani

U- 15 Vajzat	U-15 Djemtë
1. Tringa Ibraj 2. Dhurata Morina 3. Rita Guda	1. Ajan Kryeziu 2. Adriatik Avdyli 3. Erdi Grapci

U- 17 Vajzat	U-17 Djemtë
1. Erisa Beqiraj 2. Melisa Cermjani 3. Vanesa Fera	1. Bardh Guda 2. Dionis Morina 3. Andijon Aliu
1. Suela Keka 2. Olsa Zymberi 3. Alesia Kastrati	1. Baton Haxhiu 2. Dior Thaqi 3. Ertol Lenjani

Garat u mbajtën për dy ditë radhazi në të njëjtin vend. Lojtarët treguan lojëra të mira dhe vërehet një ngritje më e madhe e cilësisë dhe është rritur rivaliteti. Secili lojtar u takuan mes vete ku ngadhënjyen më të mirët.

Referimi ka qenë në nivel dhe me përgjegjësi të lartë pa ndonjë vërejtje të theksuar.

Vlenë të theksohet disiplina e lojtarëve e cila prishte rendin në gare duke lëvizur nëpër palestër, andaj u deshtën ndërhyrje të shpeshta të largimit të tyre nga hapësirat e lojës, si dhe ditën e dytë të garës pati dhe prindër të klubit të Vllaznimit brenda hapsirës së lojës ku ndërhyri në punën e referit dhe u desht të largohet nga hapësira e lojës, andaj duhet të kenë kujdes ekipet që kur pas përfundimit të garave u mbodh bordi për një takim konsultativ lidhur me kampin dhe pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare ku u vendos që: dy vendet e para të kategorisë U-13 D/V dhe U-15 D/V të shkojnë në gara në Turqi- Stamboll poashtu dhe staf 5 veta.

Të organizohet kampi përgaditor për kategoritë U-13 deri U-17 nga tre garues. Kampi të mbahet në Korçë nga data 01-06.07.2024, dhe poshtu të silltet një trajner nga Turqia, ndersa në garën e paraparë në Korçë e cila do të mbahet nga data 30.06- 01.07.2024 do të marin pjesë kategoria U-15 dhe U-17 D/V



15. Raport i turneut Ballkanik në Korçë“ Idas Frinds”

Gara u mbajtë në Korçë në shkollën “ Pandeli Cale”

28.06.2024-01.07.2024

Në këtë garë morën pjesë: Shqipëria, Kosova, Turqia, Maqedonia e Veriut në kategorinë U-15,U-17

Lojtarët e Kosovës:

1. Bardh Guda-Rogana
- 2.Dionis Morina-Arbëria
3. Erisa Beqiraj-Dardania
4. Venesa Fera-Rogana
5. Dhurata Morina-Arbëria
6. Tringa Ibraj-Vllaznimi

Gara u mbajtë në grupe (dy grupe djem dhe dy grupe vajza)

Ndërsa në garën Miks në një grup.

Rezultatet e arritura:

Bardh Guda vendi i katërt në grup

Dionis Morina vendi i katërt në grup

Erisa Beqiraj vendi i katërt në grup

Venesa Fera vendi i katërt

Dhurata Morina vendi i tretë në grup

Tringa Ibraj vendi i katërt

Ndërsa në garën Miks

Dionis Morina- Dhurata Morina vendi i shtatë

Bardh Guda- Venesa Fera vendi i tetë

Gjergji Pili- Tringa Ibraj vendi i gjashtë

Erisa Beqiraj nuk luajti në garën Miks sepse nuk pati partner.

Trener: Afrim Morina, Agron Sheremeti

Transporti u organizua me dy vetura. Rent

Në këtë garë pati një rivalitet të madh mes lojtarëve por të gjitha (tri vendet e para) ngadhënjyen Reprezentacioni nga Turqia në të gjitha konkurencat ku dy vendet e para të grupit kualifikoheshin për finale në fazën e grupeve andaj asnjë nga lojtarët e Kosovës nuk u kualifikuan për në finale por mbetën vetëm në fazën e grupeve.



Kampi i organizuar nga Federata e Badmintonit e Kosovës në Korçë me datën: 01.07.2024-06.07.2024.

Raport

Ky kamp i organizuar nga Federata e Badmintonit e Kosovës filloi me datën: 01.07.2024.

Fillimisht lojtarët dhe stafi u vendosën në hotelin “GRAND HOTEL PALACE” ku kushtet në hotel ishin relativisht të mira, si dhe ushqimi ishte në nivel.

Ditën e parë ushtrimet i filluam në ora 10 dhe çdo gjë shkoi mirë, ushtrimet udhëhiqeshin nga trajneri turk Ustun Koksali të asistuar nga trajnerët vendas, Besnik Kastrati dhe Shpresa Berisha si dhe nga kryetari i FBK-së, Lulzim Haziri.

Me ushtrime vazhduam edhe pas dite kushtet në salla ishin të mira, hapsira ishte e mjaftueshme ndriqimi i mirë, flutura poashtu kishte mjaftueshëm pasi disa flutura ishin sjellur nga treneri turk Ustuni si ndihmë për federatën e Badmintonit të Kosovës nga TBF.

Vlen të ceket se edhe në hotel ishin kushtet e mira si për ushqim ashtu edhe për të pushuar dhe për tu relaksuar pas ushtrimeve.

Lojtarët gjatë përgatitjeve ishin në nivel të duhur dhe i pranorin të gjitha këshillat dhe udhëzimet e dhëna nga trenerët edhe pse për shumicën e lojtarëve ishte një përvojë e re dhe një sfidë në vete të cilët duhet ta menaxhojnë dhe të arrijnë suksese sa më të mira për lojërat ndërkombëtare. Të gjitha këto përgatitje që janë bërë nga ana e trajnerit Ustun janë të regjistruara dhe janë një përvojë e mirë edhe për ne si trajnerë që të fitojmë një përvojë të re dhe në të ardhmen të udhëheqim vetë këto ushtrime.

Në vazhdim po i paraqes edhe disa foto gjatë qëndrimit dhe përgatitjes në kampin e badmintonit në Korçë



16. KAMPI PËRGADITOR I KOMBËTARËS U-17,U-19, 04-08.04.2024

Kampi përgatitor KAMENICË

Kombëtarja e Kosovës

04.04.2024-08.04.2024

Kampi u mbajt në Kamenicë në palestren e sportit të qytetit

Qëndrimi i kombëtares ishte në Restaurant hotel “Jehona”

Në kamp morën pjesë gjithsej 14 persona prej të cilëve 10 lojtarë, 6 lojtarë të kategorisë U-17 (3 djem, 3 vajza) dhe U-19 (2 djem, 2 vajza)

Trajneri nga Turqia, Ustun Koksall mbajti trajnimin dy herë në ditë me nga 2 orë stërvitje.

Dita e parë shkoi me përgatitjen teknike të lojës së Badmintonit, duke specializuar lëvizjet e dorës dhe lëvizjet e këmbëve si dhe lëvizjet në fushë.

Dita 2

Në këtë ditë, rëndësi e vecant ju kushtua lëvizjeve në fushë në katërkëndësh e gjashtëkëndësh si dhe shpejtësia e reagimit të lojtarit në fushë duke i zbatuar teknikat e lëvizjeve me dorë dhe këmbë.

Dita 3

Puna individuale e lojtarit në fushë si dhe teknikat e vendosjes në fushë gjatë shërbimit, kthimit të shërbimit si dhe loja individuale. E gjithë kjo u përshkua me kujdes dhe përcjellje permanente të trajnerit dhe ndihmës trajnerëve.

Dita 4

Kjo ditë u përshkua me përgatitjen e lojtarëve në lojën në qifte dhe mikse.

U punuan lëvizjet në fushë, vendosja paralele e lojtarëve gjatë lojës si dhe vendosja e lojtarëve njëri para e tjetri prapa (pozitat situacionale) gjatë lojës.

Shumë e rendësishme në këtë kamp përgatitor ishte mundësia e të mësuarit e teknikës dhe taktikës së lojtarëve gjatë lojës nga një trajner me rezultate të dëshmuara.

Lojtarët mësuan shumë nga ky trajnim i organizuar nga federata, dhe duhet të kemi trajnime të nivelit të tillë më shpesh para garave.

Vërejtje: lojtarët duhet të përgatiten më herët për mënyrën e sjelljes në tajnim sic janë: ardhja me kohë në palestër, të kenë përgatitjet e duhura (patikat, reketat), poashtu të respektojnë orarin e ushqimit dhe të gjumit.

Kampin tërë kohen e percolli Afrim Morina dhe në disa stërvitje dhe Besnik Kastrati, poashtu dhe sekretari i federatës Blerim Sylejmani

Me respekt Afrim Morina





Selektori nga Turqia na solli fanela për lojtarë dhe 4 palë trenerka dhe na tha se do të bisedojë me kryetarin e Federatës Turke për ndihmë të vazhdueshme për Federatën e Badmintonit të Kosovës.

17. RAPORTI I GARAVE CROATIA VALAMAR JUNIOR OPEN 2024

Përfaqësuesja e Kosovës mori pjesë në mesin e 24 shteteve evropiane dhe botërore nga data 11-14 Prill 2024


Në konkurrencën e meshkujve Baton Haxhiu dhe Dior Thaqi U-19 dhe në konkurrencën e femrave Fijona Mustafa dhe Suela Keka. Me trajnerët Besnik Kastrati, Shpresa Berisha Haxhiu dhe sekretari i përgjithshëm Blerim Sylejmani në cilësinë e menaxherit të ekipit.

Në garat individuale dhe garat çift lojtarët tanë treguan se janë në rrugë të mbarë për ti përmbushur objektivat.

Mirëpo në këtë konkurrencë ku marin pjesë Elita e sportit të badmintonit si Indonesia, Tajlanda, India, Malajzia Italia, Turqia, Polonia, Chekia, Zvicra, Gjermania, Anglia, Skocia, Kroacia e shumë shtete tjera që janë pjesë e Elites botërore të Badmintonit, konsideroj se për Kosovën të marrë pjesë në këtë Event është satisfakcion sepse është hera e parë që po marin pjesë në nivel të tillë.

Lojtarët tanë treguan kulturë të lartë me sjellje dhe paraqitje sportive.

Rrezultatet mund ti shihni në foto, më poshtë të nxjerura nga Federata Botërore e Badmintonit.



18:03
BWF Fan Zone

NEXT MATCH

Croatia VALAMAR Junior Open 2024

Anja BLAZINA
Ariana KORENT

21 21

Sela KOKA
Fiona MUSTAFA

5 3

ROUND R32 - EVENT WD-U19
0:19

PREVIOUS MATCH

Croatia VALAMAR Junior Open 2024

Fiona MUSTAFA

6 4

Ariana KORENT

21 21

ROUND R64 - EVENT WS-U19
0:17

a.bwfbadminton.com



18:03
BWF Fan Zone

PREVIOUS MATCH

Croatia VALAMAR Junior Open 2024

Anika IVANOVICOVA

21 21

Sela KOKA

4 6


ROUND R64 - EVENT WS-U19
0:18

PARTNERS

QUICK LINKS

a.bwfbadminton.com





18. Kursi bazik në Badminton në projektin “Shuttle Time” për mësimdhënës i mbajtur me 21/ 09/ 2024 Kolegji Don Bosko Gjilan

Kursi i Organizuar nga Federata e Badmintonit e Kosovës në bashkpunim me kolegjin Don Bosko në Gjilan dhe MKRS –në të mbështetur u mirëpritë nga të pranishmit.

Pjesëmarrës në Trajnim ishin 20 arsimtarë të Edukatës Fizike nga Komuna e Gjilanit të cilët shfaqen një interesim të jashtëzakonshëm për të mësuar për së afërmi elementet bazike në lojën e badmintonit, nën drejtimin e trajnerëve të kualifikuar Lulzim Haziri, Blerim Sylejmani, Afrim Morina dhe Besnik Kastrati.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit i ndamë në 4 grupe ku secili grup u dhamë detyrat e duhura duke i shpjeguar edhe në aspektin teorik dhe atë praktik Trajnimi u fuzionua për një ditë duke filluar ng ora 9:00 deri në orën 17:00 Gjatë ditës së parë kaluam nga mësimi 1 deri në 22, ku u informuan mbi elementet bazike në sportin e badmintonit të cilët nuk kishin patur rastin ti mësojnë më heret për sportin në fjalë, kurse pas dite u mbajtë feedback-u ku të pranishmit ishin të kënaqur dhe të befasuar me ofrimin e shërbimit nga ana jonë dhe falënderuan organizatorin me shpresën se edhe ata do të shtrijnë lojën e badmintonit në shkollat e tyre ku janë duke punuar e pse jo edhe më gjërë. Të pranishmit janë çertifikuar nga Federata Botërore e Badmintonit (BWF), dhe kanë marë titullin mësues të Badmintonit. Ky është seminari i dytë ndërkombëtar i organizuar në Gjilan.





19. Java Evropiane e Sportit BE ACTIVE 27/09/2024

Në ambientet e Hotel Edarti” në Durrës u mbajtë trajnimi për javën evropiane të sportit në programin Be Active. Veteranët prezantuan në plazhin e Durrësit. Pjesëmarrës në këtë event ishin 16 lojtarë. Java evropiane e sportit kësaj radhe zgjoi interesim tek veteranët të cilët organizuan turneun për Veteran nga mosha 45 deri në 60 vjet të cilët treguan interesim dhe shfaqën lojëra të mira.



20. Kampionati individual Air badminton për Veteran të mbajtur në Durrës me 26 dhe 27 Shtator 2024.

Në kuadër të projekteve të mbështetura nga Federata Botërore e Badmintonit, Federata e Kosovës fitoi projektin e Air Badmintonit e që u mbajt në Durrës nga 26-28 Shtator 2024.

Pjesë e këtij eventi ishin veteranët të cilët tani më janë aktiv në Klubet e Badmintonit si K.B. Don Bosko, KB.Rogana, K.B. Arbëria, K.B. Ulpiana, KB.Gjilani dhe K.B. Arbëria. Garat ishin mjaft të forta me një rivalitet të jashtëzakonshëm ku fitues i turneut ishte Afrim Morina njëherit Kampion i Kosovës, Blerim Sylejmani nënkampion i Kosovës dhe Besnik Kastrati vendi i tretë.



21. Kampionati individual në Badminton sezoni vjeshtor 19.10.2024

Në ambientet e kolegjit Imperium në Sallen e sportit në Bardhosh- Prishtinë u mbajtë kampionati i Kosovës Individual për të gjitha grupmoshat në dy gjinitë. Pjesëmarrës ishin mbi 112 garues, të cilët treguan kulturë dhe sjellje sportive gjatë gjithë kohës dhe treguan lojërë të mira. U zhvilluan garat në të gjitha kategoritë - grupmoshat U-11, U-13, U-15, U17 dhe U19 dhe Senior. Rezultatet: Pjesëmarrës në këtë eveniment ishin mbi 112 garues pjesëmarrës duke u inkorporuar 8 klube nga e gjithë Kosova. Madhështinë e këtij eventi i dhanë padyshim lojtarët e këtyre klubeve: K. B. Ulpiana, Dardania, Gjilani, Don Bosko, Zhegra Vllaznimi, Arbëria, Rogana dhe AS Prishtina, ku u arritën këto rezultate:.

U-11 Vajzat	U-11 Djemtë
Vendi i parë: Atila Hoxha	Vendi i parë: Amar Morina
Vendi i dytë: Kamelia Gola	Vendi i dytë: Endrit Avdyli
Vendi i tretë : Mjellma Mehmeti	Vendi i tretë: Dalmat Morina

U-13 Vajzat	U-13 Djemtë
Vendi i parë: Amra Lleshi	Vendi i parë: Eset Kryeziu
Vendi i dytë: Ema Delia	Vendi i dytë: Bardh Morina
Vendi i tretë: Alea Sejdiu	Vendi i tretë: Dion Dibrana

U-15 Vajzat	U-15 Djemtë
Vendi i parë: Tringa Ibraj	Vendi i parë: Ajan Kryeziu
Vendi i dytë: Rita Guda	Vendi i dytë: Adriatik Avdyli
Vendi i tretë: Eranda Aliu	Vendi i tretë: Malsor Sejdiu

U-17 Vajzat	U-17 Djemtë
Vendi i parë: Dhurata Morina	Vendi i parë: Bardh Guda
Vendi i dytë: Melisa Cermjani	Vendi i dytë: Dionis Morina
Vendi i tretë: Erisa Beqiraj	Vendi i tretë: Aid Kastrati

U-19-Seniore Vajzat	U-19-Senior Djemtë
Vendi i parë: Suela Keka	Vendi i parë: Baton Haxhiu
Vendi i dytë: Andrra Balaj	Vendi i dytë: Atlantik Ukshini
Vendi i tretë: Vanesa Fera	Vendi i tretë: Ertol Lenjani





22. TURNIRI MEMORIAL TRADICIONAL PROF. "JETON NEBIU" 24.10.2024

Sot në shkollën e mjekësisë në palestrën Imperium Medical në Bardhosh u mbajtë turneu memorial tradicional i pesti me radhë për themeluesin dhe presidentin historik prof. Jeton Nebiu. nën patronatin e Federatës së Badmintonit të Kosovës, ku me një fjalë rasti kryetari, Lulzim Haziri i përshëndeti të pranishmit dhe bëri hapjen e turneut për veteran.



Në këtë turne morën pjesë 6 Klube në kategorinë e veteranëve:

- K.B. "Don Bosko" Gjilan
- K.B. " Ulpiana" – Prishtinë
- K.B. " Gjilani" – Gjilan
- K.B. " Arbëria" –Kamenicë
- K.B. " Rogana" – Roganë
- K.B. Dardania" – Pejë

Rezultatet :

Në konkurrencën e meshkujve u arritën këto rezultate:

Në gjysëm finale u takuan Besnik Kastrati – Afrim Morina 2:0 dhe

Në Finale: Besnik Kastrati-Abedin Kuqi 1:2 dhe fitues i turneut është **Abedin Kuqi**.

Vlenë të theksohet se Turneun përkujtimor me rastin e pesë vjetorit e madhështuan edhe familjarët e tij të cilët i ndan shpërblimet për më të mirët në këtë manifestim, të cilët pos mërziisë u ndien edhe krenar me prijësin, pedagogun, babain, mikun e kolegun që na la pas, dhe u betuam se në të ardhmen ky turne të jetë ndërkombëtar.



23. Projekti Rajonal për vullnetarizëm Sofia 04-06 Tetor -2024

Në kuadër të projekteve për vullnetarizëm Kosova mori pjesë me 4 anëtarë që u mbajtë në Hotel Triada dhe në palestren e sportev Badminton Hall “Europe” në Sofje të Bullgarisë. Në kuadër të kampionatit Yonex Bulgarian International Championship 2024. Ekspeditës së Kosovës i priu Blerim Sylejmani, Ylli Morina, Euron Sylejmani dhe Andi Haxhiu të cilët për së afërmi u njoftuan për mundësit e bashkëpunimit dhe vullnetarizmit në të ardhmen. Ngjanyana maqedonase ishte presidenti Dime Stefafanovski dhe nikoqir ishte Miroslav Petrov.



24. KAMPIONATI VJESHTOR I KOSOVËS- GARAT (DOUBLE) NË BADMINTON 10.11.2024

10.11.2024 Bardhosh Palestra Imperium Medical

Në ambientet e palestrës së Sporteve Imperium Medical në Bardhosh – Prishtinë me një fjalë rasti i përshëndeti kryetari Lulzim Haziri i cili bëri hapjen e garave Double të Federatës së Badmintonit duke i inkurajuar që sportistët të tregojnë lojë cilësore me moton që ta respektojmë njëri tjetrin duke fituar më i miri. U zhvilluan garat në të gjitha kategoritë Double duke filluar nga grupmoshat U-11, U-13, U-15, U17 dhe U19 dhe Senior. Rezultatet: Pjesëmarrës në këtë eveniment ishin mbi 100 garues duke u inkorporuar 8 klube nga e gjithë Kosova. Madhështinë e këtij eventi i dhanë padyshim lojtarët e këtyre klubeve: K. B. Ulpiana, Dardania, Gjilani, Don Bosko, Vllaznimi, Arbëria, Rogana dhe, ku u arritën këto rezultate:

U11-Djemtë 1. Lorent Muji-Endrit Avdyli 2. Amar Morina-Dalmat Morina 3. Blin Morina-Aron Morina	U11-Vajzat 1. Atila Hoxha-Kamelia Gola 2. Arba Basha-Tuana Morina 3. Ermina Morina-Anea Sadiku
U13-Vajzat 1. Amra Lleshi-Mjellma Mehmeti 2. Mara Hyseni-Riga Latifi 3. Alea Sejdiu-Rumea Sejdiu	U13-Djemtë 1. Orges Morina- Eset Kryeziu 2. Bardh Morina-Nart Morina 3. Dion Dibranaj-Endrit Avdyli
U15-Vajzat 1. Dhurata Morina-Erona Morina 2. Rita Guda-Blerta Kallaba 3. Eranda Aliu-Olta Dubova	U15-Djemtë 1. Malsor Sejdiu-Endin Aliu 2. Adriatik Avdyli-Qemajl Sejdiu 3.
U17-Vajzat 1. Melisa Cermjani-Gentrina Cermjani 2. Rajana Gashi-Era Byqmeti 3. Erisa Beqiraj-Eranda Aliu	U17-Djemtë 1. Dionis Morina-Aid Kastrati 2. Andijon Aliu-Besart Ibishi 3. Bled Hoxha-Blert Gashi
U19-Vajzat 1. Suela Keka-Venesa Fera 2. Tringa Ibraj-Andra Bala 3. Olsa Zymeri-Fiona Mustafa	U19-Djemtë 1. Bardh Guda-Ertol Lenjani 2. Baton Haxhiu-Atlantik Ukshini 3. Jon Hajdari-Dior Daci







25. KAMPIONATI VJESHTOR I KOSOVËS – GARAT (MIKS) NË BADMINTON 17.11.2024

17.11.2024 Bardhosh Palestra Imperium Medical

Në ambnientet e palestrës së Sporteve Imperium Medical në Bardhosh – Prishtinë me një fjalë rasti i përshëndeti kryetari Lulzim Haziri i cili bëri hapjen e garave Miks të Federatës së Badmintonit duke i inkurajuar që sportistët të tregojnë lojë cilësore me moton që ta respektojmë njëri tjetrin duke fituar më i miri. U zhvilluan garat në të gjitha kategoritë Miks (Vajzë – djalë) duke filluar nga grupmoshat U-11, U-13, U-15, U17 dhe U19 dhe Senior. Rezultatet: Pjesmarës në këtë eveniment ishin mbi 80 garues pjesmarës duke u inkorporuar 7 klube nga gjithë Kosova. Madhështin e këtij event i dhan padyshim lojtarët e këtyre klubeve: K. B. Ulpiana, Dardania, Gjilani, Don Bosko, Vllaznimi, Arbëria, Rogana, ku u arritën këto rezultate:



U-11 Miks	U-13 Miks
1. Atila Hoxha-Endrit Avdyli 2. Mara Hyseni-Lorent Muji 3. Amar Morina-Tuana Morina	1. Eset Kryeziu-Luana Kastrati 2. Dijon Dibranaj-Amra Lleshi 3. Bardh Morina-Enuara Krasniqi

U- 15 Miks	U-17 Miks
1. Rita Guda-Ajan Kryeziu 2. Erona Morina-Nart Morina 3. Eranda Aliu-Edrin Aliu	1. Bardh Guda-Venesa Fera 2. Dionis Morina-Dhurata Morina 3. Andijon Aliu-Gentrina Cermjani

U-19 Miks	
1. Baton Haxhiu-Melisa Cermjani 2. Ertol Lenjani-Suela Keka 3. Atlanik Ukshini- Andra Bala	



26. AUSTRIAN U17 INTERNATIONAL 2024 “ Mödling, Vienna-Austria (04-06 Tetor, 2024

Me 3 Tetor 2024, Federata e Badmintonit e Kosovës, me delegacionin prej 6 anëtarëve të cilët ishin në këtë përbërje: Menaxheri i ekipit, Lulzim Haziri, Trajneri, Afrim Morina, dhe 4 lojtarët e Përfaqësuesës së Kosovës U-17, Melisa Cermjani, Erisa Beqiraj, Bardh Guda dhe Dionis Morina, u nisëm në ora 9:15 (edhe pse fluturimi ishte paraparë të niset 1 orë më herët), nga Aeroporti “Adem Jashari” për në Vjenë. Në aeroportin e Vjenës transporti na mori dhe u vendosëm në hotelin kinez PHOENIX 7 në Mödling afër Vjenës. Në këtë garë ndërkombëtare për U-17 në Modling të Austrisë morën pjesë 14 shtete: **Kosova, Austria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Polonia, Sllovakia, Sllovenia, Zvicra dhe Ukraina.**

Garat u mbajtën në **Sporthalle Mödling-Austria**

Delegacioni i Kosovës u kthye në Prishtinë me 6 tetor , 2024 në ora 14: 35. Lojtarët tanë treguan rezultate të mira, nëse i krahasojmë vitet paraprake, sporti i Badmintonit në Kosovë ka rritje dhe kjo shihet edhe nga pikët që po marrim gjatë lojërave.

Rezultatet;

Erisa Beqiraj-Julietta Döbendorfer(Zvicer)- 07-21/ 03-21

Melisa Cermjani-Tereza Skutova (Sllovaki) - 04-21/ 04-21

Dionis Morina-Alessio Cattalfamo (Itali) - 04-21/08-21

Bardh Guda-Nikita Bezsonov (Estoni)- 07-21/ 07-21

DOUBLE

Melisa Cermjani-Erisa Beqiraj - Maja Mavec-Arijalda Mustafic (Slloveni) -11-21/ 06-21

Dionis Morina-Bardh Guda - Filip Benovic-Samuel Fodor (Sllovaki) 09-21/ 04-21





27. GARAT NDËRKOMBËTARE TË MBAJTURA NË MULHEIM DER RUHR-GJERMANI


Nisja për në Gjermani gjegjësisht në qytetin e Mulheim der Ruhr,u bë nga aeroporti i Prishtinës me dt.08.10.2024 në ora 19:00,si dhe u akomoduar në hotelin B&B në Mulheim në ora 22:00.Pjesëmarrës në këtë turnir ishim me kategorin U-19 me 2 lojtarë:Baton Haxhiu dhe Suela Keka të përcjellur nga unë Shpresa Berisha-Haxhiu(menaxhere e ekipit) dhe trajneri, Besnik Kastrati.



Të nesermën me dt.09.10.2024 pasi përfunduar mëngjesin,vazhduam për në palestër ku garën e parë e filloi Suela Keka U-19 ku kundërshtarë kishte, Lalie Truant ku pësoi humbje me rezultat 21:3 ,21:14.



Lojën e dytë e filloi Baton Haxhiu U-19 ku poashtu edhe ky pësoi humbje nga kundërshtari i tij gjerman, Benn Seyffert me rezultat 21:8 dhe 21:9



Në ditët tjera në vazhdim lojtarët tanë i përcjellën garat nga afër si dhe u socializuan me shumë lojtarë të shteteve të ndryshme.

Kthimi në Kosovë ishte me datën 13.10.2024

Trajnerja dhe menaxherja e ekipit:

Shpresa Berisha-Haxhiu

28. „IV U17 PORTUGAL OPEN 2024 “ Caldas da Rainha-Portugal (22-24 Nëntor, 2024)

Më 21 Nëntor 2024, Federata e Badmintonit e Kosovës, me delegacionin prej 9 anëtarëve të cilët ishin në këtë përbërje: Menaxheri i ekipit, Lulzim Haziri, Trajnerët, Afrim Morina, Shpresa Berisha -Haxhiu, Agron Sheremeti dhe Besnik Kastrati, dhe 4 lojtarët e Përfaqësuesës së Kosovës U-17, Melisa Cermjani, Erisa Beqiraj, Bardh Guda dhe Dionis Morina, u nisëm në ora 16:05 nga Aeroporti “Adem Jashari” për në aeroportin Malpensa të Milanit ku arritëm atje në ora 18:00. Nga atje duheshim të niseshim me kompaninë EASY JET nga ora 21:10 nga Milano për në Aeroportin e Lisbonës. Pas një orë qëndrimi në aeroplan pilotët theksuan se fluturimi do të shtyhet për arsye të borës në Alpet franceze. Pas këtij lajmi të gjithë udhëtarët u dërguan në priferi të Milanit në hotelin Atlantic-Corso Repubblica, 124, Arona NO, 28941, Itali. Të nesërmën autobusi erdhi të na mar të gjithëve dhe fluturimi u arrit nga ora 14:00 për në Lisbonë. Duhet të theksohet se për shkak të vonesës së fluturimit kombëtarja e Kosovës humbi 4 ndeshje individuale. Por ne arritëm të luajmë ndeshjen e fundit për atë ditë që ishte në mes të vashave tona dhe atyre spanjolle. Pastaj nga palestra në Caldas da Rainha, transporti na mori dhe u vendosëm në hotelin Cristal në Caldas da Rainha. Në këtë garë ndërkombëtare për U-17 në Caldas da Rainha të Portugalisë morën pjesë 11 shtete: **Kosova, Anglia, Franca, Holanda, Katari, Portugalia, Peru, Malta, Zvicra, Spanja dhe Ukraina.** Garat u mbajtën në **High Performance Badminton Center**-Caldas da Rainha, Portugali.

Gjatë ditës së datës 23 nëntor takova Presidentin e Federatës së Badmintonit të Portugalisë, z **HORACIO BENTO de GOUVEIA**, ku biseduam më shumë se një orë për bashkëpunimin e dy federatave dhe Presidenti GOUVEIA më premtoi se do ta vizitoj Kosovën në marsin e viti 2025. Me mua në këtë takim prezent ishte edhe z Agron Sheremeti, Anëtar i Bordit në Federatën e Badmintonit të Kosovës.

Më 23 nëntor, 2024 në ora 1700, Delegacioni i Kosovës u prit me nderime të larta nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Lisbonë, përkatësisht nga Ambasadorja e Kosovës në Lisbon, Portugali, shkelqësia e saj z **EDONA MALOKU-BËRDYNA**. Në këtë takim u bisedua për turneun në Lisbonë dhe bashkëpunimet mes Federatës Portugeze të Badmintonit me atë të Kosovës. Ambasadorja Bërdyna na premtoi se për këtë gjë dyert do jenë të hapura për këtë bashkëpunim. Ishim tejet të gëzuar për këtë takim të ngrohtë dhe delegacioni ynë ndihej sikur në shtëpinë e vet. E njoftova Ambasadorën Bërdyna për Lojërat Mesdhetare në vitin 2030 që do mbahen në Prishtinë dhe edhe Portugalia do jetë prezente në këto lojëra.

Delegacioni i Kosovës u kthye në Prishtinë me 24 nëntor , 2024 në ora 16:00.

Rezultatet;

DOUBLE

Melisa Cermjani-Erisa Beqiraj - Nuria Alvarez-Mencia Perez (Spanje) -5-21/ 7-21

Dionis Morina-Bardh Guda - David Carvajal-Asier Torres (Spanje) 09-21/ 5-21



29. Kuvendi Zgjedhor i Federatës së Badmintonit të Kosovës

21.12.2024

(Shtëpia e Sporteve) Prishtinë

Në ambientin e shtëpisë së sporteve u mbajtë Kuvendi zgjedhor I Federatës së Badmintonit në prani të 23 delegatëve dhe dy musfirëve nga KOK-u, Besire Domaniku dhe nga DKRS, Drejtori Iber Alaj

Rendi i ditës

1. Zgjedhja e një procesmbajtësi
2. Zgjedhja e tre anëtarëve të komisionit verifikues të delegatëve
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës
4. Zgjedhja e tre anëtarëve të komisionit zgjedhor
5. Propozimi i kandidatit për kryetar të federatës
6. Votimi për pozitën e kryetarit të federatës
7. Votimi për pozitën e nënkryetarit të federatës
8. Votimi për pozitën e 5 anëtarëve të bordit të FBK-së
9. Zgjedhja e 3 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës
10. Të ndryshme
11. Mbyllja e kuvendit zgjedhor.

Kuvendi nisi punimet në ora 14:10

Mbledhjen e kuvendit të rregullt zgjedhor e hapi kryetari i federatës Lulzim Haziri, i cili pershendeti delegatët e kuvendit dhe përfaqësuesin e KOK-ut, Besire Domaniku dhe drejtorin e Departamentit të Sportit, Iber Alaj.

1. Blerim Sylejmani propozoi që procesmbajtës të jetë Afrim Morina, u hodh në votim dhe u votua unanimisht PËR.
2. Nga delegatët u propozua që anëtar të komisionit verifikues të jenë: Zeqer Lenjani, Selami Haziri, dhe Erduan Morina, kjo pikë u hodh në votim dhe unanimisht delegatët votuan PËR.
Komisioni pasi verifikoi listat e nënshkruara konstatoi se në kuvend janë 21 delegatë dhe kuorumi është për të vazhduar mbledhjen.
3. Kryetar i federatës hodhi në votim rendin e ditës dhe unanimisht u votua PËR
4. Kryetari i FBK-së kërkoi nga delegatët që të propozojnë tre anëtarë të komisionit zgjedhor: Gëzim Elshani, Fiona Mustafa, Korab Fazliu.
5. Prezentimin e kandidatit për kryetar të federatës së badmintonit e bëri Blerim Sylejmani në cilësinë e delegatit nga K.B. "Don Bosko".
6. Përfaqësuesja e KOK-ut Besire Domaniku, kërkoi që me Aklamcion të votohet pasi nuk ka kundërkandidat, ashtu dhe u veprua e u hodh në votim ku të gjithë delegatët votuan PËR, asnjë kunder, asnjë Abstenim, me këtë rast u shpall kryetar i FBK-së, Lulzim Haziri edhe për një mandat 4 vjeçar.

Lulzim Haziri falenderoi delegatët për besimin e dhënë dhe premtoi bashkëpunim si dhe rritjen e numrit të klubeve të badmintonit nëpër tërë Kosovën deri në 15 Klube të jenë aktivë.

7. Për nënkryetar të FBK-së u propozua Shpresa Berisha-Haxhiu, kundërkandidat tjetër nuk pati andaj edhe kjo pikë u votua me Aklamacion dhe të gjithë delegatët votuan PËR asnjë kundër dhe asnjë Abstenim, e me këtë rast Shpresa Berisha Haxhiu u shpall nënkryetare e FBK-së.
8. Për anëtar të bordit u votua në pako për këta anëtarë: Agron Sheremeti, Afrim Morina, Tefik Fazliu, Nerxhivane Rafuna, Olsa Zymberi, edhe kjo pikë u hodh në votim dhe të gjithë delegatët votuan PËR, asnjë kundër asnjë Abstenim.
9. Për anëtar të Komisionit Mbikëqyrës u propozuan: Arlind Behluli, Naim Murtezi dhe Avni Bllaca, dhe pasi u hodh në votim kjo pikë e rendit të ditës të gjithë delegatët votuan PËR.
10. Iber Alaj përshendeti të pranishmit dhe i uroj kryetarit punë të mbarë e suksese.
Diskutime tjera për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati.
11. Kuvendin e shpalli të mbyllur Kryetari i Federatës, Lulzim Haziri në ora 15:00



Procesmbajtësi: Afrim Morina

Sekretari: Blerim Sylejmani

30. RAPORTI I GARAVE TOP 5 TË MBAJTURA NË PALESTRËN IMPERIUM MEDICAL NË PRISHTINË ME 26.01.2025

